



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.04.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 16.04.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Truly Nolen" për aktivitetin: "Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-1347-211 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "**Truly Nolen**" e datës 16.04.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" me Nr.616 18 1347 211 Nr. Brendshëm 616 18 036 211 kundër *Njoftimit për kontratë* të AK –së, të datës 09.03.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Vërtetohet Njoftimi për kontratë i publikuar me datë: 09.03.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "**Truly Nolen**" me datë 16.04.2018 ka parashtruar kërkesën-ankesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Deratizimi i kanalizimit, bodrumeve dhe garazhave publike" me Nr.616 18 1347 211 Nr. Brendshëm 616 18 036 211 ".
Autoriteti Kontraktues, me datë 18.04.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1. Lidhur me kontestimin e çmimeve, respektivisht me pretendimin se vlera e parashkuar për realizim të projektit është nën cmimin e tregut, në kemi kërkuar sqarimet nga Njësia e kërkesës dhe nga përgjegjja rezultoi se ju keni dhënë një çmim real për preparatin, por jo edhe për

stacionet sepse sipas jush çmimi është 4.5 euro, ndërsa sipas Njesisë së kerkesës çmimi është 3,00 euro.

Në bazë të përgjegjes nga Njësia e kerkesës realisht shihet se kjo mund të realizohet edhe pse jo me ndonjë fitim të duhur.


Por si do që të jetë ne tani nuk kemi mundësi të bëjmë ndryshime buxhetore dhe duhet t'i përmbahemi vlerës së parashikuar, ndërsa çmimet reale besoj do ti kemi pas hapjes së tenderëve, ku do të shihet se a janë çmimet sipas parashikimeve apo do ti tejkalojnë të njejtat dhe nëse pretendimet tuaja janë reale, atëherë besojmë se asnjë tenderues nuk konkuron që të krijoj humbje, por do të vendosin çmimet reale dhe pastaj ne duhet të veprojmë në harmoni me të njejtat.

Prandaj nuk shohim arsye që të bëhen ndryshime në vlerën e parashikuar, pasi që treguesi më i mirë për çmimet real do të jenë çmimet e tenderuesëve pjesëmarrës.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet dhe konstatimet e paraqitura më lartë ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit